

Verejtje dhe komente mbi
mesazhin

“Keshtu thote Zoti:
Shqiperia do te thirret me
emrin e Zotit.”

Hyrje.....	3
Komente dhe verejtje.....	4
Disa parime baze qe duhet te kemi parasysh.....	4
Verejtje rreth thelbit te mesazhit.....	4
Atributet e profecise.....	4
Reagimi ndaj zerit profetik.....	6
Verejtje rreth qendrimit te kapitenit ne historine e rrethimit te sireve.....	7
Verejtje rreth seksionit: Kur te vije, a do ta dallosh?	8
Verejtje rreth profecise se dhene	10
Permbledhje	11
Shtojce	12

Hyrje

Qellimi i ketij artikulli eshte te jape komente dhe verejtje rreth mesazhit te perhapur pak dite me pare: Keshtu thote Zoti: Shqiperia do te thirret me emrin e Zotit.”.

Ky mesazh eshte botuar ne nje reviste, eshte perhapur ne facebook si dhe predikohet ne takime te zhvilluara enkas per kete qellim.

Jam munduar te paraqes nje arsyetim racional, te bazuar ne Fjalen e Perendise, ne lidhje me pikepamjet dhe mesimet qe jepen ne kete mesazh.

Jam munduar qe te gjykoj me sa me shume paanesi mesazhin, qe nga thelbi i tij deri ne detajet.

Ne seksionin “Komente dhe verejtje” kam paraqitur komente te bazuara ne menyre te drejtperdrejte dhe te dukshme ne Fjalen e Perendise.

Ne seksionin “Shtojce” kam paraqitur komente te cilat bazohen ne Fjalen e Perendise, por gjithsesi jo ne menyre aq te dukshme sa ato ne pjesen e pare.

Komente dhe verejtje

Shqiperia do te thirret me emrin e Zotit.

Nje fjale qe shumekush do ta perkrahte sapo ta degjonte. Nje thirrje qe del nga thellesia e zemres se Zotit.

Zoti eshte duke pregatitur kishen e tij ne Shqiperi.

Ne c'menyre Zoti do te levize? Si do ta rrise dhe si do te levize Zoti ne kishen?

Disa parime baze qe duhet te kemi parasysh.

- Perendia do te drejtoje vetem me ane te Fjales se Tij. Tek 2 Tim. 3:15 lexojme: *"I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi,"* Nuk ka autoritet ligjvenes ne te cilin duhet te bazojme jeten tone pervec se te Fjala e Perendise. Nuk mund te bazohemi ne nje mesazh apo fjale qe dikush thote qe vjen nga Perendia, nese ajo nuk gjen perputhje me Fjalën e Perendise. Jezusi shpeshhere veprimet qe kryente i bazonte dhe ua shpjegonte dishepujve permes shkrimit (Luk 24:27).
- Perendia eshte Ati, Fjala dhe Fryma e Shenjte. Dhe keta te tre jane nje. Do te thote qe Fryma nuk vepron pa Fjalën dhe Fjala nuk vepron pa Frymen. Fryma nuk mund te manifestohet, nese me pare nuk eshte manifestuar Fjala.
- Profecite (kuptohet, jo profecite e shkruara ne Bibel, por ato te thena nga besimtare qe kane dhuraten perkatese) duhet te testohen. 1 Kor. 14:29: *Le të flasim dy a tre profetë, dhe të tjerët të gjykojnë.* Duke u bazuar edhe ne piken e mesiperme, hapi i pare per te testuar nje profeci eshte nese ajo eshte ne perputhje me Fjalën e Perendise.
- Perendia, ndonese eshte sovran dhe i gjithpushtetshem, ndonese nuk ka asgje te pamundur per te, ka "rruget" e Tij ne te cilat vepron, ligjet e Tij te cilat qeverisin boten shpirtore. Perendia nuk vepron ne cfaredo rruge qe njerezit mund te mendojne se mund te veproje. P.sh. Perendia ne kohen ne te cilen derdh lavdine e Tij, e gjykon mekatin menjehere (kujtojme mekatin e genjeshtres ne kohen e kishes se pare, ne kohen kur lavdia e Perendise ishte ne bashkesi).

Verejtje rreth thelbit te mesazhit.

Atributet e profecise

Mesazhi ne reviste, faqe 4.

Permendet 4 here me force qe "zeri profetik" te drejton.

Sqarim: kur flasim per "profeci" ne kete mesazh, kuptojme profecine e cila jepet permes nje besimtari i cili ka dhuraten e profetizimit, jo per profecite e thena ne Bibel nga apostujt apo profetet.

1 Kor. 14:3 shprehet ne kete menyre per profecine: *"Kurse ai që profetizon, u flet njerëzve për ndërtim, për nxitje e përdëllim."*

Duhet te bejme kujdes, qe tiparet e profecise, apo te zerit profetik, jane ato qe shkrimi thote. Shkrimi nuk permend qe tipare te profecise jane te drejtuarit drejt "eksperiencave te paimagjinuara si te mundshme", "lirise", "shenjterimit", "bollekut", "fitores", "thellesite e mistereve te fshehura ne zemren e Perendise", apo qe profecia te drejton te Ai. Ndonese disa prej tyre jane te kuptueshme (p.sh. cdo gje qe vjen nga Perendia te drejton te Ai, rrjedhimisht edhe profecia) duhet te bejme kujdes kur flasim dhe shprehim attribute te caktuara per dhuntite e dhena nga Perendia. Duhet gjithmone t'u permbahemi zbuleses dhe percaktimit qe eshte dhene ne Fjalen e Perendise. Pra, atributet e lartpermendura per profecine nuk pershkruhen ne Fjalen e Perendise.

Eshte shume e rendesishme te theksojme edhe nje here qe eshte Fjala e shkruar e Perendise ligji shpirtoror suprem. Perendia drejton me ane te Fjales se Tij. Kjo eshte aresyeja qe mbare shkrimi thekson rendesine e jashtezakonshme te njohjes se Fjales se Perendise:

Rom. 15:14: *Dhe, sa për ju, o vëllezër, më është mbushur mendja për ju, se edhe ju jeni plot mirësi, plot me çdo njohuri, të zotë të këshilloni njëri-tjetrin.*

2 Kor. 2:14: *Por, falem nderit Perëndisë, që na bën të ngadhënjëmë gjithnjë në Krishtin dhe shfaq kudo nëpërmjet nesh erën e këndshme të njohurisë së vet.*

2 Kor. 4:6: *sepse Perëndia që tha: "Le të ndriçojë drita në errësirë", është i njëjti që shkëlqeu në zemrat tona për t`na ndriçuar në njohurinë e lavdisë së Perëndisë, në fytyrën e Jezu Krishtit.*

Ef. 1:17: *që Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdisë, t`ju japë juve Frymën e diturisë dhe të zbulesës, në njohurinë e tij,*

Ef. 3:19: *dhe ta njihni dashurinë e Krishtit që tejkalon çdo njohuri, që të mbusheni me tërë plotësinë e Perëndisë.*

Fil. 1:9: *Dhe për këtë lutem që dashuria juaj të teprojë gjithnjë e më shumë në njohuri dhe në çdo dallim,*

Kol. 3:10: *edhe veshët njeriun e ri, që përtërihet në njohurinë sipas shëmbullit të atij që e krijoi.*

Atributet e permendura per profecine:

Te drejton drejt eksperiencave te paimagjinuara si te mundshme

Eshte besimi baza kryesore me ane te te cilit ne arrijme te shohim te pamunduren dhe ate qe nuk eshte ashtu sikur te ishte (Heb 11:1, Rom 4:17). Per profecine, Fjala e Perendise nuk paraqet kete atribut.

Te drejton ne liri

Jezusi shprehet ne kete menyre per te drejtuarit drejt lirise:

“Do ta njihni te verteten dhe e vertata do t’ju beje te lire”.

Njohja e Fjales se Perendise eshte ajo qe do te na drejtoje ne liri. Ndonese mund te ndalemi dhe te shtjellojme shume gjere kete teme, gjeja me kryesore qe dua te permbledh eshte qe, per te gezuar lirine e plote, vemendja dhe perkushtimi duhet te drejtohet drejt njohjes se Fjales. Shume kristiane bien pre e mendimeve te tyre. Ata krijojne nje imazh te gabuar ne lidhje me qendrimin e Perendise per nje suate te caktuar dhe veprojne sipas atij imazhi duke e drejtuar veten drej “roberise”, mungeses se lirise. Prandaj Jezusi, pasi kishte funksionuar ne dhuratat shpirtore per te cliruar (u kishte sjelle lirine) shume njerez nga demonet, drejton vemendjen drejt njohjes se Fjales per te sjelle lirine dhe jo drejt dhuratave shpirtore: “Do ta njihni te verteten dhe e vertata do t’ju beje te lire”.

Qellimi i profecise nuk eshte “te te drejtoje ne liri”.

Te drejton ne thellesite e mistereve te fshehura ne zemren e Perendise

Perendia e ka zbuluar teresisht natyren e Tij ne Fjalen e Tij. Nese ne duam te njohim Perendine, atehere duhet te studiojme cfare thote Ai per veten e Tij ne Fjale. Ne kete Fjale, natyra e Tij zbulohet edhe permes profecive dhe librave te profeteve. Por duke patur parasysh parimet baze te permendura ne fillim, duhet te kuptojme qe profecite e thena sot nga besimtare qe kane marre dhuraten e profetizimit nuk ndihmojne ne zbulimin e natyres se Perendise. Ato nuk mund te merren sadopak per baze per njohjen e thellesive te fshehura ne zemren e Perendise. Keto thellesi, jane zbuluar ne Fjalen e Tij. Ndersa ne lexojme dhe mesojme dhe meditojme mbi Fjalen e Tij, Shpirti i Shenjte do te na zbuloje pjese te natyres se Perendise. Qellimi i profecise nuk eshte “te te drejtoje ne thellesite e mistereve te fshehura ne zemren e Perendise”.

Reagimi ndaj zerit profetik

Ne mesazh shprehet: “Sa here qe degjojme zerin profetik, duhet te mesojme si te reagojme.”

Absolutisht e vertete. Eshte nje proces mesimi si duhet te reagojme ndaj profecise.

Fjala e Perendise na zbulon si duhet te reagojme:

1 Kor. 14:29: *Le të flasin dy a tre profetë, dhe të tjerët të gjykojnë.*

1 The. 5:20: *Mos i përbuzni profecitë.*

Verejtje per qendrimet e sugjeruara ne mesazh:

“pranojme” dhe **“besojme”** – absolutisht jo. Fjala meson qe reagimi ndaj profecise eshte “te gjykuarit e saj”, nese eshte ne perputhje me Fjalen e Perendise.

1 Kor. 14:29: *Le të flasin dy a tre profetë, dhe të tjerët të gjykojnë..*

Njeriu frymeror, i cili eshte ushtruar nga Perendia per te gjykuar (Psalmi 99:4) ne baze te nivelit shpirtor qe ka arritur, mund te gjykoje profecine.

1 Kor 2:15 *Por njeriu që është frymëror gjykon çdo gjë dhe vetë nuk është i gjykuar nga asnjëri.*

“festojme” – ky qendrim nuk udhezohet nga asnje pjese e shkrimit.

“nderojme” – edhe ky qendrim nuk udhezohet nga asnje pjese e shkrimit. Nje shkrim i cili i perafrohet eshte 1 The. 5:20: *Mos i përbuzni profecitë.* Por gjithsesi nuk flitet per “nderim” te profecise, sidomos perpara se te kemi gjykuar nese eshte nga Perendia apo jo.

Pra Fjala e Perendise na meson si te reagojme: “te mos e perbuzim” dhe “ta gjykojme nese eshte nga Perendia” nje profeci.

Verejtje rreth qendrimit te kapitenit ne historine e rrethimit te sireve.

Ne mesazh permenden dy aresye pse kapiteni deshtoi ne reagimin e tij ndaj profecise. Qendrimi i tij ishte “talles” dhe “skeptik dhe mosbesues”.

Verejtje: kapiteni deshtoi jo ne qendrimin “talles”, por perbuzi profecine dhe jo ne qendrimin “skeptik dhe mosbesues”, por deshtoi ne te gjykuarit e profecise, nese ajo vinte nga Perendia apo nga njeriu. Ai nuk i kushtoi kujdes, prandaj edhe gjykimi i Perendise erdhi mbi te.

Te kemi kujdes! Qendrimi yne nuk duhet te jete “ta pranojme” dhe “ta besojme” nje profeci qe nga paraqitet. Nga ana tjeter, nuk duhet ta anashkalojme. Perkundrazi, duke mos pasur nje qendrim “perbuzes”, duhet ta gjykojme sipas Fjales. Eshte teper e rrezikshme te rendim pas profecive, pa i analizuar me pare ato, pa i gjykuar ne driten e Fjales se Perendise. Qendrimi i Ezekias ishte korrekt, ai nuk e perbuzi profecine dhe Perendia veproi ne situaten perkatese ne jeten e tij.

Verejtje rreth seksionit: Kur te vije, a do ta dallosh?

Ne mesazhin e botuar ne reviste, ne faqen 8 shkruhet: "Cfare ne zgjedhim do te vendose nese do shpallemi te perulur nga Perendia apo jo".

Verejtje: Duhet theksuar se perulesia eshte nje fryt i cili arrihet me ane te nje procesi i cili zgjat per nje kohe te gjate. Gjithmone e me teper, sa me shume ne ushtrohemi ne perendishmeri nga Perendia, ne japim frytin e perulesise. Nese jemi te perulur, kjo gjykohet nga nje bashkesi e madhe qendrimesh qe ne mbajme ne situata te caktuara. Perulesia nuk mund te matet vetem me nje zgjedhje qe mund te bejme ne nje situate. Pra, cfare ne do te zgjedhim nje moment, nuk do te sherbeje qe te shpallemi apo jo te perulur nga Perendia. Perkundrazi do te jene zgjedhjet e shumta ne situata te ndryshme qe do te sherbejne qe ne te shpallemi te perulur apo jo.

Ai po vjen ne menyre ofenduese.

Ne kete seksion te verejtjeve, po permbledh tre pasazhe nga mesazhi, per shkak se te treja kane te bejne me reagimin e besimit ndaj nje sjelljeje ne dukje "ofenduese" te Perendise:

Historia e sjelljes se Jezusit me Samaritanet

Verejtje: Nuk ka asnje paralelizem qe mund te behet mes veprimit te Jezusit ne Samari dhe veprimit te Tij ne kishen e Tij. Samaria nuk eshte shembelltyra e kishes, perkundrazi jane Izraeli dhe Jeruzalemi. Pra, mesazhi i dhene per historine me Samaritanet nuk ka lidhje me kishen.

Historia e ushtrise se Gideonit

Komenti dhe interpretimi i dhene mendoj qe eshte i sakte. Ne thelb qendron besimi, i cili duhet te veproje edhe atehere kur inteligjenca provon qe veprimi i propozuar eshte marrezi (1 Kor. 2:14). Usharet e Gideonit nuk mund te kuptonin me mendjen e tyre se c'lidhje ka menyra si pine uje me betejn qe i priste. Perendia po i provonte nese ata do te ishin te bindur ne kete rast, ne menyre qe ata te vepronin po keshtu edhe me vone.

Historia e gruas kananease ne seksionin "A do te gjeje BESIM"

Verejtje: Duhet te kemi parasysh qe Jezusi eshte autori dhe perfunduesi i besimit tone. Ne kete histori, kjo grua kishte nevojte te besonte per te marre nje mrekulli nga Perendia. Jezusi ne fillim nuk po i pergjigjej, me pas refuzon dy here ta kryeje mrekulline.

Jezusi po sterviste besimin e gruas.

Mund te flasim gjate rreth kesaj teme, por cka lidhet me mesazhin eshte qe kjo grua ishte ne procesin e mesimit dhe te trajnimit real nga Perendia ne lidhje me besimin e saj.

Verejtje e pergjithshme per mesazhin e shprehur: **Ai po vjen ne menyre ofenduese.**

Ne historite e lartpermendura, shohim qe Perendia perdor menyren "ofenduese" per te trajnuar bijte e tij ne besim. Menyra ofenduese do te beje qe ne te veprojme vetem me besim dhe te anashkalojme intelektin tone. Nese mendja jone natyrore mund te thote "Perendia eshte ofendues", mendja e transformuar (Rom. 12:2) do te thote nje mori vargjesh nga shkrimi qe "Perendia eshte i mire".

POR

Perendia nuk e derdh lavdine e Tij ne menyre "ofenduese".

Nuk duhet te ngaterrojme rastet kur Jezusi mesoi dhe trajnoi dishepujt me rastet kur Ai u shfaq ne lavdi (shfaqja e Jezusit ne lavdi eshte te Gjon. 12:12-32, mali i shperfytyrimit (Luk 9:29, Mat 17:2), etj).

Ne te gjitha rastet kur Perendia ka ardhur ne lavdi, duke filluar qe nga shfaqjet e prezences se Tij ne malin e Sinait dhe me pas ne tabernakull ne kohen e Moisiut (p.sh. Eks: 40: 34-38), me pas ne kohen qe Jezusi veproi ne toke dhe deri te veprat e apostujve (dita e Rreshajeve Vep. 2:1-47) e me pas ne ringjalljet e mepasshme ne kohen e apostujve, nuk ka asnje rast kur Perendia te kete derdhur lavdine ne menyre ofenduese.

Koha e tanishme eshte kohe peregatitjeje. Me pelqen pa mase te them "koha e "ushtrimit" tone nga Perendia" (1 Tim. 4:6: *Shmangu pra nga përrallat profane dhe të të vjetërve, edhe ushtrohu në perëndishmëri*).

Nese me mendjen natyrore do te perceptojme nje veprim nga Perendia si "ofendues", kjo eshte per t'u ushtruar ne perendishmeri dhe besim, qe gjykimi nga mendja frymerore te triumfoje mbi gjykimin me mendjen natyrore. Dhe ky eshte nje proces ushtrimi. Nese menyra "ofenduese" do te perdoret nga Perendia, kjo kohe eshte tani. Ai nuk do te vije ne menyre ofenduese ne lavdine e Tij. Ai do te veproje tani ne menyre ofenduese per te ushtruar bijte e Tij. Nese Ai do te vije ne lavdi, qe, sic profetizohet ne mesazh, do te vije se shpejti, Ai do te vije me shenja dhe mrekulli, por jo me menyra "ofenduese".

Verejtje rreth profecise se dhene

Kombet do te degjojne dhe mahniten nga fuqia e zerit tend dhe do te thone: "Ja kombi i zgjedhur, i thirrur me emrin Tim".

Verejtje: Se pari duhet theksuar se kombi qe Perendia zgjodhi dhjetra shekuj me pare eshte dhe vazhdon te jete ende kombi i Izraelit. Pasi Jezusi derdhi gjakun e Tij, ketij kombi "te zgjedhurish" iu shtuan te gjitha ata qe do te besonin nga kombet pagane (Gjon 10:16, shih edhe Rom. 11:1-36). Perendia nuk e sheh kombin shqiptar si te vecuar dhe si "te zgjedhur". Perkundrazi "te zgjedhurit" e Tij ne kohen qe po jetojme jane te gjitha besimtares ne bote, nga nje shumice kombesh. Ne shkrim nuk permendet asnje komb tjetër qe do te thirret "i zgjedhur". Eshte pra vetem nje komb te cilin Perendia e vecon dhe e therret si "i zgjedhur". Fjalet "Ja kombi i zgjedhur, i thirrur me emrin Tim" tingellojne shume te bukura, por mund t'i atribuohen vetem kombit te Izraelit, asnje kombi tjetër.

"Une do te vij ne nje menyre dhe rruge qe shume do ta vene ne pyetje"

Verejtje: Perendia yne eshte nje Perendi i rregullit. Sic e permendem ne seksionin e parimeve qe duhet te kemi parasysh, Perendia ka rruget dhe ligjet e Tij ne te cilat vepron. Me pare se te kryeje nje veprim, ai meson bijte e tij, perhap njohurine e tij rreth asaj qe Ai do te beje. Pra, perpara se te derdhe lavdin e Tij, ai do te mesoje bijte e Tij rreth menyres se si Ai do ta derdhe lavdine e Tij, nese ajo qe do te manifestohet do te jete ne perputhje me ligjet e Tij. Dhe mesimi i Perendise gjithmone do te bazohet ne shkrim. Perendia kurre nuk do te mesoje dicka me ane te thenieve te besimtareve, qofte edhe te pjekur ne besim, nese ajo nuk argumentohet ne shkrim.

Disa referenca nga shkrimi:

Zan. 18:17: *Dhe Zoti tha: "A do t'ia fsheh unë Abrahamit atë që kam për të bërë?"*

Ketu shohim deshiren e Perendise per t'i zbuluar besimtareve planet e Tij.

Vep. 15:28: *Në fakt na u duk mirë Frymës së Shenjtë dhe neve që të mos ju ngarkojmë asnjë barrë tjetër përveç këtyre gjërave të nevojshme.*

Ketu shohim marrredhenien qe Perendia krijon me besimtares. Ai kishte "diskutuar" me Palin per planet per kishen e Antiokise.

Amos. 3:7 *Sepse Zoti, Zoti, nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve.*

Ne menyre superlative, Perendia shprehet per menyren se si ua zbulon gjerat e fshehura te Tij besimtareve.

Permbledhje

Per te permbledhur verejtjet:

Mesazhi profetik si dhe vete profecia jane ne kundërshtim me Fjalën e Perëndisë:

1. Perëndia nuk vjen ne lavdi ne menyre ofenduese. Menyren "ofenduese" ai e perdor ne kohën e "ushtrimit", jo ne kohën e ardhjes ne lavdi.
2. Profetizohet ne menyre te gabuar qe: "do te jene shume ata qe do ta vene ne pyetje veprimin e Tij. Shkrimi zbulon qe Perëndia zbulon sekretin e Tij me pare, Ai i pajis bijte e Tij me njohuri mbi rruget e Tij.
3. Shqipëria nuk do te cilesohet nga Perëndia si "komb i zgjedhur". Kete cilesim Perëndia ia ka atribuar vetem kombit te Izraelit. Te gjithë besimtaret, nga cdo komb, pa dallim, jane "shartuar" me kombin e Izraelit, me "kombin e zgjedhur".
4. Mesim i gabuar ne lidhje me profecine. Cilesohet ne menyre te gabuar qe profecia sherben per te drejtuar rreth: "eksperiencave te paimagjinuara si te mundshme", "lirise", "shenjterimit", "bollekt", "fitores", "thellessive te mistereve te fshehura ne zemren e Perëndisë", kurse shkrimi cileson qe profecia sherben per ndërtim, për nxitje e përdëllim.
5. Mesim i gabuar ne lidhje me reagimin ndaj profecise. Mesohet qe duhet reaguuar me "feste", "nderim", "pranim" dhe "besim", nderkohe qe shkrimi meson qe reagimi duhet te jete "jo perbuzes" dhe "te gjykohet nese eshte nga Perëndia"

Shtojce

Verejtje rreth disa detajeve ne mesazh

- Ne faqen 3 thuhet:

"Perkundrazi, Ai beson ne ty. Beson se do dish te reagosh me pjekuri". Ketu prezantohet koncepti i "besimit" te Perendise tek njerezit. Pa dashur te keqkuptoj thenien e autorit, mund te them qe kjo eshte nje shprehje per te inkurajuar besimtaret, per t'u treguar atyre qe Perendia nuk eshte kunder tyre por eshte me ta. Deri ketu ne rregull. Por konceptin e "besimit" te Perendise te njerezit nuk e shohim ne kontekstet biblike. Tek Gjon 2:24. thuhet: *"por Jezusit nuk u zinte besë atyre, sepse i njihite të gjithë, : Gjithesesi Perendia nuk "beson" se ti do te besh nje veper te mire, nuk eshte "optimist" se ti do te ecesh ne vepra te mira. Perkundrazi, Ai i ka krijuar veprat e mira qe me pare, qe ne te ecim ne to (Ef. 2:10). Pra, edhe veprat qe ne kryejme, jane ideuar, jane krijuar qe me pare nga Perendia qe ne te ecim ne to.*

- Ne faqen 9 perskruhet xhelozia si mekat i njeriut. Referencat qe jepen edhe nga shkrimi flasin per xhelozine e Perendise per Izraelin, jo per xhelozine e bijve te Izraelit. Xhelozia qe Izraeli i shkakton Perendise eshte sepse ai shkon pas forces se vet dhe pas "demoneve" (pas idhujve te kombeve) per te gjetur ndihme dhe nuk i drejtohet Perendise.

- Ne faqen 6 thuhet:

"Do ta shfryj hidherimin tim."

Verejtje: Nuk shohim ne shkrim qe Perendia shfryn "hidherimin" e Tij.

Perendia shfryn "zemerimin" e Tij.

Bibla flet per hidherimein e njerezve, jo te Perendise.

Disa nga vargjet ku flitet per hidherimin jane paraqitur me poshte. Kudo flitet per hidherimin e njerezve, jo te Perendise.

Vargu	Permbajtja
Genesis 16:11	Engjelli i Zotit i tha akoma: "Ja, ti je me barrë dhe do të lindësh një djalë dhe do ta quash Ismael, sepse Zoti mori parasysh hidhërimin tënd;
Genesis 26:35	Keto u bënë shkas për një hidhërim të thellë të Isakut dhe të Rebekës.
Exodus 33:4	Kur populli degjoi këto fjalë të kobshme, ndjeu një hidhërim të thellë, dhe askush nuk vuri stolitë e tij.
Numbers 5:24	Pas kesaj do t`i japë gruas për të pirë ujë të hidhur që sjell mallkimin dhe ky ujë që sjell mallkimin do të hyjë në të për të prodhuar hidhërim;
Numbers 5:27	Mbas pirjes se ujit, do të ndodhë që, në se ajo është fëlliqur dhe ka kryer një pabesi ndaj burrit të saj, uji që sjell mallkimin do të hyjë në trupin e saj për të prodhuar hidhërim; barku i saj do të fryhet, ijët e saj do të dobësohen dhe ajo grua do të bëhet një mallkim në mes të

Vargu	Permbajtja
	popullit të saj.
Ruth 1:20	Ajo iu pergjegj atyre: "Mos më quani Naomi; thirr mëni Mara, sepse i Plotfuqishmi më ka mbushur me hidhërim.
1st Samuel 1:16	Mos mendo se sherbëtorja jote është një grua e çoroditur, sepse ka qënë dhëmbja dhe hidhërimi i pamasë që më shtynë të flas deri tani".
1st Samuel 15:32	Pastaj Samueli tha: "Me sillni Agagun, mbretin e Amalekitëve". Agagu shkoi tek ai me qejf. Agagu thoshte: "Me siguri hidhërimi i vdekjes ka kaluar".
2nd Samuel 2:26	Ateherë Abneri thirri Joabin dhe tha: "Shpata, vallë duhet të gllabërojë gjithnjë? Nuk e di ti që në fund do të ketë hidhërim? Vallë, kur do ta urdhërosh popullin të mos ndjekë më vëllezërit e tij?".
2nd Samuel 16:12	Ndoshta Zoti do ta shohe hidhërimin tim dhe do të më bëjë të mira në vend të mallkimeve që më drejton sot".
1st Kings 22:27	Kështu thotë mbreti: "Futeni këtë në burg dhe ushqeheni me bukë dhe me ujë hidhërimi, deri sa të kthehem shëndoshë e mirë".
2nd Chronicles 18:26	dhe u thoni atyre: Kështu thotë mbreti: "Futeni këtë në burg dhe ushqejeni me bukë dhe me ujë hidhërimi, deri sa unë të kthehem shëndoshë e mirë".
Nehemiah 9:9	Ti ke parë hidhërimin e etërve tanë në Egjipt dhe ke dëgjuar britmën e tyre pranë Detit të Kuq.
Esther 4:1	Kur Mardokeu mësoi të gjitha ato që kishin ndodhur, grisi rrobat e tij, u mbulua me një thes dhe me hi dhe doli nëpër qytet, duke lëshuar britma të forta dhe plot hidhërim;
Job 3:20	Pse t`i japësh dritë fatkeqit dhe jetën atij që ka shpirtin në hidhërim,
Job 7:11	Prandaj nuk do ta mbaj gojën të mbyllur do të flas në ankthin e frymës time; do të ankojem në hidhërimin e shpirtit tim.
Job 9:18	Nuk më lë të marr frymë, përkundrazi më mbush me hidhërim.
Job 30:16	Unë shkrihem përbrenda, dhe ditët e hidhërimit më kanë pushtuar.
Psalms 69:20	Fyerja e rëndë më ka copëtuar zemrën dhe jam plot hidhërim; prita dikë që të më përdëllentë por më kot; prita dikë që të më ngushëllonte, por nuk u paraqit asnjë.
Psalms 77:10	Unë kam thënë: "Shkaku i hidhërimit tim është se dora e djathtë e Shumë të Lartit ka ndryshuar".
Proverbs 17:21	Atij që i lind një budalla do t`i vijë hidhërim dhe ati i një budallai nuk mund të ketë gëzim.
Proverbs 17:25	Biri budalla është një burim vuajtjesh për atin e tij dhe hidhërim për atë që e ka lindur.
Ecclesiastes 5:17	Përveç kësaj ai ha çdo ditë të jetës së tij në errësirrë, dhe ka shumë hidhërim, sëmundje dhe telashe.
Isaiah 22:4	Prandaj them: "Largoni shikimin nga unë; unë do të qaj me hidhërim. Mos kërkoni të më ngushëlloni për dëshpërimin e bijës së popullit tim".
Isaiah 33:7	Ja, heronjtë e tyre bërtasin nga jashtë, lajmëtarët e paqes qajnë me hidhërim.
Isaiah 38:15	Çfarë të them? Ai më ka folur dhe ai vetë e ka bërë këtë gjë. Unë do

Vargu	Permbajtja
	të eci ngadalë gjatë tërë viteve të mia, në hidhërimin e shpirtit tim.
Isaiah 38:17	Ja, është për paqen time që kam provuar hidhërim të madh; por në dashurinë tënde ke çliruar shpirtin tim nga gropa e korrupsionit, sepse i ke hedhur prapa krahëve të tua të tëra mëkatet e mia.
Jeremiah 22:10	Mos qani për të vdekurin, mos mbani zi për të, por qani me hidhërim të madh për atë që niset, sepse nuk do të kthehet më dhe nuk e ka për të parë më vendin ku ka lindur.
Jeremiah 45:3	Ti thuaj: "Mjerë unë, sepse Zoti i shton hidhërimin dhembjes sime; unë jam lodhur së rënkuari dhe nuk gjej prehje".
Jeremiah 48:5	Mbi të përpjetën e Luhithit po ngjiten duke qarë në hidhërim, ndërsa në tatëpjetën e Horonaimit dëgjohet zëri plot ankth i disfatës.
Lamentations 1:2	Ajo qan me hidhërim natën, lotët vijëzojnë faqet e saj; midis gjithë atyre që e donin nuk ka njeri që ta ngushëllojë; tërë miqtë e saj e kanë tradhëtuar, janë bërë armiq të saj.
Lamentations 3:1	Unë jam njeriu që pa hidhërimin nën thuprën e tërbimit të tij.
Lamentations 3:5	Ka ndërtuar fortesa kundër meje, më ka rrethuar me hidhërim dhe me ankth.
Lamentations 3:15	Më ka ngopur me hidhërim, më ka bërë të pij pelin.
Lamentations 3:19	Kujtohu për pikëllimin dhe për endjen time, për pelinin dhe hidhërimin.
Lamentations 3:33	sepse nuk e bën me kënaqësi poshtërimin dhe hidhërimin e bijve të njerëzve.
Ezekiel 4:16	Pastaj më tha: "Bir njeriu, unë do të bëj të mungojë baza e bukës në Jeruzalem; ata do ta hanë bukën me peshë dhe në hidhërim dhe do të pijnë ujin e racionuar në tmerr,
Amos 6:12	Vallë, a rendin kuajt mbi shkëmbinjtë ose a lërohen ata me qe? Por ju e ktheni të drejtën në helm dhe frytin e drejtësisë në hidhërim,
Matthew 26:75	Atëherë Pjetri kujtoi atë që i kishte thënë Jezusi: `` Para se të këndojë gjeli, do të më mohosh tri herë ``. Dhe ai doli përjashta dhe qau me hidhërim.
Luke 22:62	Atëherë Pjetri doli përjashta dhe qau me hidhërim.
2nd Corinthians 2:1	Por unë kisha vendosur në veten time të mos vij përsëri te ju me hidhërim.
Ephesians 4:31	Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi.
Hebrews 12:11	Çdo ndreqje, pra, aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij.
Hebrews 12:15	duke u kujdesur fort që askush të mos mbetet pa hirin e Perëndisë dhe se mos mbijë ndonjë rrënjë e hidhur dhe t`ju turbullojë dhe me anë të saj të ndoten shumë njerëz;
James 3:14	Por në qoftë se ne zemrën tuaj keni smirë të hidhur dhe grindje, mos u mbani me të madh dhe mos gënjeni kundër së vërtetës.

